



DEF Département de l'enseignement
et de la formation professionnelle
DGEO Direction générale de l'enseignement
obligatoire et de la pédagogie spécialisée

Certifikimi në fund të vitit të 11-të

Informim për prindërit

**Shkolla e dytë
(arsimi i mesëm i ulët)**

Viti i 11-të S

Shkolla e detyrueshme shtrihet në njëmbëdhjetë vjet. Ajo synon që nxënësi të marrë dijeni dhe aftësi, të zhvillojë dhe të ushtrojë aftësitë e veta intelektuale, krijuese, fizike e në punë dore, dhe të formojë gjykimin dhe personalitetin e vet. Shkolla i lejon nxënësit të përfshihet në jetën shoqërore, profesionale dhe qytetare përmes njohjes së vetvetes dhe të botës që e rrethon, si dhe përmes respektimit të të tjerëve.

Duke ardhur në vijim të fletëpalosjes që paraqet vitin e 9-të e të 10-të të shkollës së dytë I (cikli 3), ky dokument përshkruan kushtet e certifikimit të nxënësve të vitit të 11-të dhe kushtet e hyrjes në klasat e rakordimit, në klasat e mësimi plotësues, si dhe në formimet pas shkollës së detyrueshme.

www.vd.ch/scolarite

Burimet : Loi sur l'enseignement obligatoire (LEO)
Règlement d'application de la LEO (RLEO)
Cadre général de l'évaluation (CGE)

Bazë janë vetëm kuadri ligjor e rregullator dhe Kuadri i përgjithshëm (CGE), që trajton në mënyrë shterruese rastet e ndryshme.

Organizimi dhe tabela e orarit

Shkalla e dytë I përmban dy drejtime: drejtimin parajimnazial (VP) dhe drejtimin e përgjithshëm (VG). Në ciklin 3, nxënësi ndjek mësimet sipas objektivave të përcaktuara nga Plani romand i studimeve (PER) dhe programet kantonale. Në vitin e 11-të, tabela e orarit përmban 33 periudha në javë. Metodat e punës, strategjitë e të nxënësit, aftësia për të bashkëpunuar dhe për të komunikuar trajtohen në dhënien e të gjitha lëndëve.

Vlerësimi

Vlerësimi i punës së nxënësit njoftohet përmes agjendës në formën e notave që shkojnë nga 1 deri në 6 me gjysmë-pikë (TS dhe TA). Nota 4 përkon me pragun e mjaftueshmërisë. Nota më e lartë është 6-ta, nota më e ulët 1-shi.

Mesataret e mara prej nxënësit mbahen parasysht sipas një sistemi me kusht të dyfishtë: vendimet lidhur me rrugëtimin e nxënësit bazohen në shumat e pikëve të mara në grupin kryesor të përbërë nga të gjitha lëndët nga njëra anë dhe në një grup të kufizuar lëndësh nga ana tjetër.

Në mbarim të semestrit dhe të vitit shkollor, jepet një vlerësim i gjendjes. Ai përmban një listë të notave dhe të mungesave, si dhe mesataret e lëndëve të përcaktuara me gjysmë-pikën më të afërt. Në fund të vitit shkollor dhe në rast ndërrimi të drejtimt apo të nivelit në mbarim të semestrit të 1-rë, një dëftesë jep mesataret dhe tregon vendimin lidhur me rrugëtimin e nxënësit. Kjo dëftesë i bashkëngjitet librezës shkollore.

Certifikata e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë

Në fund të vitit shkollor, organizohet provimi i certifikatës në institucionin shkollor. Mënyrat e organizimit të provimeve përshkruhen me më shumë hollësi në pjesët *Drejtimi parajimnazial* dhe *Drejtimi i përgjithshëm*.

Për të marrë certifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë, nxënësi duhet të ketë ndjekur mësimet e vitit të 11-të gjatë tërë vitit dhe të jetë paraqitur në të gjitha provimet.

Certifikata e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë jepet në bazë të mesatareve të mara në fund të vitit të 11-të. Mesataret e fundit të vitit vendosen sipas mënyrave që vijojnë:

- Për lëndët që nuk janë objekt provimi, mesatarja vjetore përfundimtare përkon me mesataren vjetore, të rrumbullakosur me gjysmë-pikë;
- për lëndët që janë objekt provimi, mesatarja vjetore përfundimtare mban parasysht mesataren vjetore në masën 80% dhe notën e marrë në provim në masën 20% (shih shembullin e llogaritjes më poshtë).

Nxënësit dhe prindërit e tyre kanë mundësinë të shikojnë fletët e provimit pasi ato të jenë korigjuar.

Plani romand i studimeve (PER)

www.plandetudes.ch

PER-ja përcakton përmbajtjen e të nxënësit të shkollimit të detyrueshëm për Zvicrën romande. Ai përshkruan atë që nxënësit duhet të mësojnë gjatë njëmbëdhjetë viteve të shkollimit.

Punët domethënëse (travaux significatifs, TS) (përdorimi i njohurive): Në mënyrë të rregullt dhe gjatë tërë vitit, vlerësimi i punës shkollore të nxënësit bëhet me ndihmën e punëve domethënëse. Ato përbëjnë elementet thelbësore të vlerësimit. Çdo punë domethënëse synon të paktën një objektiv mësimor të përcaktuar nga Plani romand i studimeve (PER) me një apo disa prej përbërësve të tij që kanë qenë objekt i një mësimdhënieje.

Punët e përvetësuara (travaux assimilés, TA) (përvetësimi i njohurive): Një sërë punësh që verifikojnë vetëm përvetësimin e njohurive ose të teknikave të veçanta. Të gjitha këto punë janë objekt i një note për çdo lëndë. Për çdo lëndë, numri i punëve të përvetësuara nuk mund të kalojë një të katërtën e tërësisë së punëve të përcaktuara.

Mesatarja vjetore, shembull llogaritjeje

Mesatarja e notave të mara në klasë	4.2
Nota e marë në provimin e certifikatës	4.5
Llogaritja: $(4.2 \times 0.8) + (4.5 \times 0.2) =$	4.3
Mesatarja vjetore përfundimtare (e rrumbullakosur me gjysmë-pikë)	4.5

Drejtimi parajimnazial

Provimet

Në drejtimin parajimnazial, provimet kanë të bëjnë me lëndët që vijnë:

- frëngjisht; - anglisht ;
- matematikë ; - zgjedhje të posaçme (OS).
- gjermanisht;

Të gjitha lëndët janë objekt i një provimi me shkrim dhe një provimi me gojë. Në frëngjisht, matematikë, gjermanisht e anglisht, provimet me shkrim janë të njëjta për të gjithë nxënësit e kantonit. Provimet e OS-ve si dhe të gjitha provimet me gojë kryhen prej institucioneve shkollore. Notat e mara në provimin me shkrim dhe në provimin me gojë japin një notë të vetme provimi për çdo lëndë, që rrumbullakoset me gjysmë-pikë. Në frëngjisht e në matematikë, nota e provimit mban parasysh notën e marë në kontrollin me shkrim në masën e dy të tretave dhe atë të marë në kontrollin me gojë në masën e një të tretës. Në gjermanisht dhe në anglisht, nota e provimit mban parasysh notën e marë në kontrollin me shkrim në masën e tri të katërtave dhe atë të marë në kontrollin me gojë në masën e një të katërtës.

Kushtet e certifikimit

Kushtet e certifikimit janë të njëjta si ato për kalimin nga një vit në tjetrin në shkollën e dytë. Për të marrë certifikatën e përfundimit të studimeve të shkallës së dytë, **nxënësi i drejtimit parajimnazial** duhet të marrë të gjitha pikët vijuese për të dy grupet:

Grupi kryesor	frëngjisht + matematikë + gjermanisht + zgjedhje e posaçme + anglisht + shkencat e natyrës + gjeografi - qytetari + histori - etikë e kulturë fetare + artet vizuale + muzikë	40 pikë e sipër
Grupi i kufizuar	frëngjisht + matematikë + gjermanisht + zgjedhje e posaçme	16 pikë e sipër
<i>Rastet e veçanta</i>	<i>e shumta 0.5 pikë pamjaftueshmëri për grup.</i>	

Hyrja në formimet pas shkollimit të detyrueshëm

Nxënësi që ka marë certifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë të drejtimit parajimnazial ka qasje në tërësinë e degëve të formimit pas arsimit të detyrueshëm, nga gjimnazi në të nxënit e një profesioni.

Marrja e certifikatës së drejtimit të përgjithshëm për nxënësit e VP-së mbetës

Me kërkesë të prindërve, nxënësi që nuk e ka marrë certifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë të drejtimit parajimnazial mund të marrë certifikatën e drejtimit të përgjithshëm nëse i merr të gjitha pikët vijuese për të dy grupet:

Grupi kryesor	frëngjisht + matematikë + gjermanisht + zgjedhje e posaçme + anglisht + shkencat e natyrës + gjeografi - qytetari + histori - etikë dhe kulturë fetare - artet vizuale + muzikë	38.5 pikë e sipër
Grupi i kufizuar	frëngjisht + matematikë + gjermanisht + zgjedhje të posaçme	14,5 pikë e sipër
<i>Rastet e veçanta</i>	<i>e shumta 1 pikë pamjaftueshmëri për grup.</i>	

Për të hyrë në shkollat e kulturës së përgjithshme dhe të tregtisë të gjimnazeve apo maturës profesionale, madje edhe në klasat e rakordimit 2, nxënësi i VP-së mbetës që e ka marë certifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë të drejtimit të përgjithshëm duhet të ketë rezultatet vijuese:

Mesatarja vjetore përfundimtare 4 e sipër, të paktën në dy lëndë të grupit të kufizuar, përfshirë frëngjishten dhe/ose matematikën.

Drejtimi i përgjithshëm (VG)

Kushtet e kalimit nga një nivel në tjetrin (semestri i 1-rë)

N1 > N2 Në fund të semestrit të parë, kalimi nga niveli 1 në nivelin 2 është i mundur për nxënësin që gjatë semestrit në një lëndë me nivel ka një mesatare prej:
- 5.5 e sipër;
- 5, me mendimin paraprak të mësuesit/es të lëndës.

N2 → N1 Me kërkesën e prindërve ose me mendimin paraprak të mësuesit/es të lëndës, nxënësi mund të kalojë nga niveli 2 në nivelin 1.

Provimet

Në drejtimin parajgjimnazial, provimet kanë të bëjnë me lëndët që vijojnë:

- frëngjisht; - anglisht;
- matematikë; - zgjedhje të aftësive të orientuara drejt profesioneve (OCOM) artizanale, artistike, tregtare ose teknologjike (AACT) (ose zgjedhje të posaçme-OS).
- gjermanisht;

Frëngjishtja, matematika, gjermanishtja dhe anglishtja janë objekt i një provimi me shkrim dhe një provimi me gojë. OCOM AACT-ja është objekt i një provimi me gojë dhe/ose me shkrim, apo në një formë tjetër në përshtatje me përmbajtjet e saj. Në frëngjisht, matematikë, gjermanisht e anglisht, provimet me shkrim janë të njëjta për të gjithë nxënësit e kantonit. Provimet e OCOM AACT-ve (ose të OS-ve) si dhe të gjitha provimet me gojë kryhen prej institucioneve shkollore. Notat e mara në provimin me shkrim dhe në provimin me gojë japin një notë të vetme provimi për çdo lëndë, që rrumbullakoset me gjysmë-pikë. Në frëngjisht e në matematikë, nota e provimit mban parasysht notën e marë në kontrollin me shkrim në masën e dy të tretave dhe atë të marë në kontrollin me gojë në masën e një të tretës. Në gjermanisht dhe në anglisht, nota e provimit mban parasysht notën e marë në kontrollin me shkrim në masën e tri të katërtave dhe atë të marë në kontrollin me gojë në masën e një të katërtës.

Kushtet e certifikimit

Kushtet e certifikimit janë të njëjta me ato të kalimit nga një vit në tjetrin në shkallën e dytë. Për të marrë certifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë, **nxënësi i drejtimit të përgjithshëm** duhet të marrë të gjitha pikët vijuese për të dy grupet, cilido qoftë niveli i ndjekur në frëngjisht, matematikë e në gjermanisht:

Grupi kryesor	frëngjisht + matematikë + gjermanisht + zgjedhje artizanale, artistike, tregtare ose teknologjike (ose OS) + anglisht + shkencat e natyrës + gjeografi - qytetari + histori - etikë e kulturë fetare + artet vizuale + muzikë+ veprimtari krijuese e punë dore / edukimi i të ushqyerit	44 pikë e sipër
Grupi i kufizuar	frëngjisht + matematikë + gjermanisht + zgjedhje artizanale, artistike, tregtare ose teknologjike (ose OS)	16 pikë e sipër
<i>Rastet e veçanta</i>	<i>e shumta 1 pikë pamjaftueshmëri për grup.</i>	

Paraqitje e ciklit 3

Një fletëpalosje shpjeguese lidhur me ciklin e 3-të gjendet në sitin tonë të Internetit : www.vd.ch/scolarite > Déroulement de l'école obligatoire dans le canton de Vaud.

Zgjedhje e aftësive të orientuara drejt profesioneve (OCOM) të drejtimit të përgjithshëm

Një fletëpalosje shpjeguese lidhur me OCOM-të gjendet në sitin tonë të Internetit : www.vd.ch/scolarite > Déroulement de l'école obligatoire dans le canton de Vaud.

Hyrja në formimet pas arsimit të detyrueshëm

Nxënësi që e ka marë certifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë në drejtimin e përgjithshëm mund të hyjë në degët vijuese të formimit profesional: vërtetimin federal të formimit profesional dhe certifikatën federale të aftësisë.

Hyrja në shkollat e kulturës së përgjithshme dhe të tregtisë të gjimnazeve ose maturës profesionale

Nxënësi që ka marë certifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë të drejtimit të përgjithshëm mund të hyjë në shkollat e kulturës së përgjithshme dhe të tregtisë të gjimnazeve ose maturës profesionale me kushtet e mëposhtme:

Tri lëndët e ndjekura në nivelin 2: frëngjisht + matematikë + gjermanisht ose Dy lëndë të ndjekura në nivelin 2 dhe një lëndë të ndjekur në nivelin 1: frëngjisht + matematikë + gjermanisht	13,5 pikë e sipër 14,5 pikë e sipër
<i>Rastet e veçanta e shumta 0,5 pikë pamjaftueshmëri në shumën e të gjitha pikëve.</i>	

Klasat e vitit të 12-të certifikues për nxënësit e VG-së mbetës

Klasat e vitit të 12-të certifikues për nxënësit e drejtimit të përgjithshëm që kanë mbetur për herë të dytë në provimin e certifikatës ose që e kanë përsëritur klasën dy herë gjatë shkollimit të tyre. Ato u mundësojnë nxënësve marrjen e certifikatës së studimeve të shkallës së dytë të drejtimit të përgjithshëm në përfundim të një viti studimesh shtesë.

Me rezervë të moshës (e shumta 17 vjeç të mbushura më 31 korrik), nxënësi/ja i/e interesuar dhe i/e motivuar mund të pranohet në vitin e 12-të certifikues. Kjo përçapje bëhet me konsultim midis prindërve dhe nxënësit.

Në mënyrë të përgjithshme, **rastet e veçanta** kanë të bëjnë me rrethanat në të cilat rezultatet e nxënësit janë shumë pak poshtë atyre të kërkuara për plotësimin e kushteve të certifikimit ose të hyrjes në klasat e rakordimit, si dhe të pranimit në shkollat e kulturës së përgjithshme dhe të tregtisë të gjimnazeve. Nacioni i rasteve të veçanta nuk zbatohet për vendimet e kalimit nga një nivel në tjetrin. Këshilli drejtues vendos kryesisht për rastet e veçanta.

Këshilli drejtues çmon, me kërkesën e prindërve, **rrethanat e veçanta** të gjasshme (për shembull një shkollim i trazuar rëndë e për një kohë të gjatë nga një sëmundje e zgjatur, nga mbërritja rishtazi nga një kanton tjetër apo nga jashtë vendit). Që një rrethanë e veçantë të merret parasysh, duhet që një sukses i mëpasshëm të jetë i mundshëm.

Vendimet për kalimin nga një nivel në tjetrin, për certifikimin, pranimin në klasat e rakordimit ose në vitin e 12-të certifikues si dhe në shkollat e kulturës së përgjithshme të tregtisë të gjimnazeve mund të jenë objekt **ankimi** pranë Departamentit: *Instruction des Recours, Département de l'enseignement et de la formation professionnelle, rue de la Barre 8, 1014 Lausanne*. Ankimi i motivuar bëhet me shkrim brenda një afati 10-ditor nga njoftimi i vendimit, dhe shoqërohet me një kopje të vendimit të kundërshtuar.

Klasat e rakordimit në dalje nga drejtimi i përgjithshëm

Klasat e rakordimit kanë për qëllim që, në përfundim të një viti mësimor shtesë dhe me disa kushte, t'i mundësojnë nxënësit hyrjen në degë të ndryshme të formimit pas arsimit të detyrueshëm.

Në shumë institucione të shkollimit të detyrueshëm të shpërndara në territorin e kantonit të Vaudit, ka klasa të rakordimit.

Regjistrimi për të ndjekur një klasë të rakordimit duhet të bëhet prej prindërve, në fund të muajit janar, pranë institucionit shkollor të ndjekur prej fëmijës së tyre në vitin e 11-të. Në parim, fëmija shkollohet në institucionin shkollor më të afërt me vendin e banimit.

Klasat e rakordimit 1

Pas një viti shtesë në shkollimin e detyrueshëm, klasat e rakordimit 1 i mundësojnë nxënësit që ka marrë certifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë të drejtimit të përgjithshëm të arrijë rezultatet që lejojnë hyrjen në shkollat e kulturës së përgjithshme dhe të tregtisë të gjimnazeve ose të maturës profesionale.

Nxënësi/ja i/e certifikuar në drejtimin e përgjithshëm mund të hyjë në klasën e rakordimit 1 me kushtet e vijuese:

Tri lëndët e ndjekura në nivelin 2: frëngjisht + matematikë + gjermanisht ose Dy lëndë të ndjekura në nivelin 2 dhe një lëndë të ndjekur në nivelin 1: frëngjisht + matematikë + gjermanisht ose Një lëndë të ndjekur në nivelin 2 dhe dy lëndë të ndjekura në nivelin 1: frëngjisht + matematikë + gjermanisht ose Tri lëndë të ndjekura në nivelin 1: frëngjisht + matematikë + gjermanisht	12 pikë e sipër 13 pikë e sipër 14 pikë e sipër 15 pikë e sipër
<i>Rastet e veçanta e shumta 0,5 pikë pamjaftueshmëri në shumën e të gjitha pikëve.</i>	

Klasat e rakordimit 2

Pas një viti shtesë në shkollimin e detyrueshëm, klasat e rakordimit 2 i mundësojnë nxënësit që ka marrë certifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë të drejtimit të përgjithshëm të marrë certifikatën e drejtimit paragjimnazial.

Nxënësi/ja i/e certifikuar në drejtimin e përgjithshëm mund të hyjë në klasën e rakordimit 2 nëse ai apo ajo ka ndjekur tri lëndët me nivel në nivelin 2 dhe nëse ai apo ajo i ka marrë të gjitha pikët vijuese në të dy grupet (pa llogaritur OCOM AACT-të):

Grupi kryesor	frëngjisht + matematikë + gjermanisht + anglisht + shkencat e natyrës + gjeografi - qytetari + histori - etikë dhe kulturë fetare + artet vizuale + muzikë + veprimtari krijuese dhe punë dore / edukim i të ushqyerit	46.5 pikë e sipër
Grupi i kufizuar	frëngjisht + matematikë + gjermanisht	15 pikë e sipër
<i>Rastet e veçanta e shumta 0,5 pikë pamjaftueshmëri për grup.</i>		

Klasat e rakordimit

Një fletëpalosje shpjeguese lidhur me klasat e rakordimit gjendet në sitin tonë të Internetit: www.vd.ch/scolarite > Déroulement de l'école obligatoire dans le canton de Vaud.

Marrëdhënia shkollë-familje

Shkolla siguron kryesisht arsimimin e fëmijëve dhe u njeh prindërve përparësinë në fushën edukimit. Megjithatë, këto misione nuk e përjashtojnë njëra tjetrën, meqenëse bashkëpunimi i familjeve kërkohet në fushën e arsimimit edhe shkolla ndihmon familjet në fushën e edukimit.

Mësuesi/ja kujdestar/e i/e klasës, si dhe drejtorja e institucionit shkollor janë bashkëbiseduesit përparësorë të prindërve për sa i përket shkollimit të fëmijës së tyre, për arsye të marrëdhënies së afërsisë që ata kanë me fëmijën.

Prindërit informohen rregullisht për nxëniet shkollore dhe vlerësimin që rrjedh prej tyre. Ata dëgjojnë para çdo vendimi të rëndësishëm që ka të bëjë me rrugëtimin shkollor të fëmijës së tyre. Vendimet përfundimtare i takojnë këshillit drejtues.

Të paktën një herë në vit, në parim në fillim të vitit shkollor, organizohet një seancë informuese për prindërit. Kjo bën të mundur ndër të tjera shpjegimin e mbarëvajtjes së shkollimit, e objektivave të planit mësimor dhe të kushteve të vlerësimit.

Informacionet e shkollës u njoftohen rregullisht prindërve përmes agjendës të nxënësit, të cilën ata e nënshkruajnë në fund të çdo jave. Është pikërisht përmes saj që prindërit dhe mësuesit/et mund të kërkojnë një takim. Këto shkëmbime, që mund të bëhen në çdo moment të vitit shkollor, sigurojnë një bashkëpunim të mirë.


Masa pedagogjike plotësuese mund të merren kur kjo është e nevojshme për të siguruar përparimin e nxënësit. Shërbime të tjera mund të jepen nga psikologët, psikomotricienët, apo logopedistët në mjedisin shkollor (PPLS), në përputhje me procedurat e vendosura nga institucioni shkollor sipas veçantive të veta.

Informacione që kanë të bëjnë pikërisht me pritjen pas mësimit apo me shërbime të tjera mund të merren pranë drejtorisë së institucionit shkollor.

		Rac1 et Rac2 viti i 12-të certifikues		shkalla e dytë (arsimi i mesëm i ulët)
14 - 15 vjeç	11S	cikli i tretë drejtimi i përgjithshëm	cikli i tretë drejtimi paragjimnazial	
13 - 14 vjeç	10S			
12 - 13 vjeç	9S			
11 - 12 vjeç	8P	cikli i dytë fillor		shkalla e parë (arsimi fillor)
10 - 11 vjeç	7P			
9 - 10 vjeç	6P			
8 - 9 vjeç	5P			
7 - 8 vjeç	4P	cikli i parë fillor		
6 - 7 vjeç	3P			
5 - 6 vjeç	2P			
4 - 5 vjeç	1P			

Struktura e shkollës së detyrueshme vaudeze

Struktura e shkallës së dytë I (arsimit të mesëm të ulët) dhe hyrja në formimet pas arsimit të detyrueshëm



¹ Mundësi, me disa kushte, për të marrë një zgjedhje të posaçme

Më shumë informacione lidhur me formimet pas arsimit të detyrueshëm në www.vd.ch/dgep.

Më shumë informacione lidhur me orientimin drejt profesioneve, degët e formimit dhe masat e tranzicionit në www.vd.ch/orientation.



www.vd.ch/scolarite

www.vd.ch/page/2020664

